

## KOSOVË

Kushtetuta parashikon lirinë e fesë, dhe ligjet e politikave të tjera i kontribuuan ushtrimit në përgjithësi të lirë të fesë.

Qeveria në përgjithësi e respektoi lirinë e fesë në praktikë. Nuk pati asnjë ndryshim në statusin e respektimit të lirisë së fesë nga Qeveria gjatë periudhës raportuese.

Dhuna shoqërore shënoi rënie, por tensionet ndërmjet bashkësive mbeten të larta, posaçërisht pas shpalljes së pavarësisë së vendit në shkurt të vitit 2008. Ndonëse dukej që diskriminimi dhe dhuna shoqërore ishin në përgjithësi me motive etnike, lidhja e ngushtë ndërmjet përkatësisë etnike dhe fesë e bëri më të vështirë të përcaktohej nëse ngjarjet ishin të motivuara nga armiqësia etnike apo fetare.

Si pjesë e politikës së vet të përgjithshme për mbështetjen e të drejtave të njeriut, Qeveria Amerikane i diskuton çështjet e lirisë së fesë me Qeverinë dhe përfaqësues fetarë. Qeveria Amerikane ndërhyri në raste specifike për të siguruar që vendet e adhurimit që i përkasin Kishës Ortodokse Serbe (KOS) dhe vendet e tjera të trashëgimisë kulturore të jenë të mbrojtura.

### Seksioni I. Demografia fetare

Kosova ka një sipërfaqe prej përafërsisht 10,900 km<sup>2</sup> dhe dy milionë banorë, ndonëse regjistrimi i fundit i besueshëm është bërë në vitet e 80-ta. Feja mbizëtoruese, e pranuar nga pjesa më e madhe e popullatës shumicë shqiptare, nga bashkësia boshnjake, gorane dhe turke, si dhe nga disa anëtarë të bashkësisë rome/ashkallike/egjiptiane, është feja islame. Megjithatë, feja nuk është faktor i rëndësishëm në jetën publike. Retorika fetare mungonte shumë nga fjalimi publik në bashkësitë myslimane, pjesëmarrja në xhami ishte e ulët, dhe paraqitjet publike të rrobave dhe të kulturës konservatore islame ishin minimale. Popullata serbe, që llogaritet prej 100,000 – 120,000 veta, është kryesisht ortodokse serbe. Katolikët romanë dhe protestantët përbëjnë më pak se pesë për qind të popullatës. Bashkësitë katolike janë të përqendruara përreth kishave katolike në Prizren, Klinë dhe Gjakovë. Protestantët kanë popullata të vogla në shumicën e qyteteve, por përqendrimi i tyre më i madh është në Prishtinë.

### Seksioni II. Statusi i respektimit të lirisë së fesë nga Qeveria

#### Korniza ligjore/politike

Kushtetuta parashikon lirinë e fesë, dhe ligjet e politikave të tjera i kontribuuan ushtrimit në përgjithësi të lirë të fesë.

Ligji pohon të drejtën për lirinë e shprehjes, ndërgjegjes, dhe fesë për të gjithë qytetarët pavarësisht nga bindjet e tyre fetare. Ai parashikon ndarjen e bashkësive fetare nga institucionet publike dhe të drejta e detyrime të barabarta për të gjitha bashkësitë fetare, dhe përcakton që nuk ka fe zyrtare. Ligji gjithashtu i definon dispozitat unike ligjore që parashikojnë të drejta e detyrime të barabarta për të gjitha bashkësitë fetare dhe ndalon diskriminimin e bazuar në fe dhe përkatësi etnike.

Qeveria i pranon disa, por jo të gjitha festat fetare të besimit mysliman, katolik dhe ortodoks si festa zyrtare, përfshirë këtu Eid-al-Adha [Kurban Bajramin], fillimin e Ramazanit, Eid-al-Fitr [Fiter Bajramin], pashkët ortodoksë, kërshtëndellat ortodokse dhe perëndimore.

Nuk ka rregullore për regjistrim të detyrueshëm për grupe fetare; megjithatë, për të blerë pronë ose për të marrë mjete financiare nga organizatat ndërkombëtare, grupet fetare duhet të regjistrohen pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike si organizata joqeveritare (OJQ).

Ligji dhe rregulloret parashikojnë ndarje ndërmjet sferës fetare dhe publike, dhe ua ndalojnë institucioneve të arsimit publik ofrimin e arsimit fetar ose të veprimtarive të tjera që mbështesin ndonjë fe specifike,

Kufizimet mbi lirinë e fesë

Qeveria në përgjithësi e respektoi lirinë e fesë në praktikë. Nuk pati asnjë ndryshim në respektimin e lirisë së fesë nga Qeveria gjatë periudhës raportuese.

Udhëheqësit fetarë u ankuan se duhet të kenë status të veçantë përveç atij të OJQ-ve. Udhëheqësit islamikë u ankuan për mungesë të statusit ligjor për fenë e tyre. Udhëheqësit protestantë gjithashtu e theksuan këtë problem, duke vënë në pah se një kishë protestante është e detyruar ta përdorë numrin e vet të identifikimit tatimor si dëshmi të vetme të statusit të saj ligjor. Protestantët u ankuan se pa regjistrim zyrtar dhe ligjor bashkësia nuk mund të zgjidhte shumë prej problemeve me të cilat ballafaqohet lidhur me regjistrimin e tokës dhe marrjen e lejeve për ndërtim.

Protestantët pohuan diskriminim institucional nga qeveria qendrore dhe qeveritë komunale. Për shembull, ata u ankuan se nuk u lejuan ta regjistronin pronën në emër të kishave të tyre apo ta themelonin një varrezë protestante, gjë që shpesh rezultonte që protestantët të varroseshin në varreza myslimane, dhe në shumë raste klerikët myslimanë i kryenin shërbimet e varrimit për protestantët. Ata pohuan se kjo ishte shkelje e të drejtës së tyre për t'u varrosur në mesin e personave të fesë të tyre, dhe ishte imponim i një tradite tjetër fetare mbi ta. Protestantët gjithashtu raportuan se mungesa e liritë nga tatimi për importimin e mallrave të dhuruara bamirëse i pengonte përpjekjet e tyre.

Udhëheqësit islamikë u ankuan për vëmendje të pamjaftueshme për çështje dhe aktivitete fetare nga radiotelevizioni publik i Kosovës (RTK). Protestantët deklaruan se RTK-ja posaçërisht ngurronte të raportonte për fenë protestante.

Ministria e Arsimit ndaloi mbajtjen e shamive, posaçërisht në shkollat ku veshja e uniformës ishte e detyrueshme, përkundër një vendimi të vitit 2004, të lëshuar nga ombudspersoni, se ai rregull duhet të zbatohet vetëm për mësimdhënës dhe nëpunës të shkollës, e jo për nxënës. Më 12 dhjetor 2008, një gazetë ditore raportoi se një mësimdhënëse në komunën e Klinës u suspendua nga puna për shkak të mbajtjes së shamisë në vend të punës. Drejtori i shkollës dhe zyrtarë të tjerë komunalë e cituan këtë si shkelje të rregullës nga mësimdhënëset që mbajnë shami. Sipas Zyrës së Ombudspersonit, Ministria e Arsimit u pajtua, dhe mësimdhënësja gjoja vendosi të mos kthehej në vend të punës nëse nuk i lejohej ta mbante shaminë. Ombudspersoni gjithashtu raportoi se në një rast të ngjashëm nga periudha e mëparshme raportuese, mësimdhënësja e dëmtuar më vonë vendosi ta lëshonte vendin e punës. Në një rast tjetër, në shtator 2008, zyra rajonale e Ombudspersonit në Gjilan raportoi se një grua nuk ishte pranuar si mësimdhënëse për shkak se mbante shami.

Zyra e Ombudspersonit dhe Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) u ankuan se nxënëset myslimane vazhdonin të përjashtoheshin nga shkollat publike për shkak se mbanin shami. Ombudspersoni raportoi se një rast nga shtatori 2008 ishte zgjidhur në favor të nxënëses, e cila në fund u lejua të kthehej në shkollë--me shami--në mars 2009.

Protestantët gjithashtu raportuan se komuna e Deçanit, duke cituar reagime negative nga qytetarët lokalë, vazhdonte t'ua mohonte lejen për ndërtimin e një objekti kishtar në tokën private që e kishin blerë. Rasti gjyqësor lidhur me dhënien e lejes për ndërtim mbeti para Gjykatës Supreme në fund të periudhës raportuese. Protestantët gjithashtu raportuan për raste të tjetra të vazhdueshme në të cilat kongregacioneve të tyre vazhdimisht u mohohesh leja për të ngritur ndërtesa të reja kishtarë në tokën në pronësi të kishës.

Nuk pati raportime për të burgosur ose të ndaluar fetarë në Kosovë.

#### Ndërrimi i detyrueshëm i fesë

Nuk pati raportime për ndërrim të detyrueshëm të fesë, përfshirë këtu një numër të vogël të shtetasve amerikanë që ishin rrëmbyer ose në mënyrë të paligjshme ishin larguar nga SHBA-ja, ose që nuk ishin lejuar të ktheheshin në SHBA.

#### Përmirësimet dhe zhvillimet pozitive lidhur me lirinë e fesë

Komisioni shumetnik për zbatimin e rindërtimit (KZR) rifilloi punën e vet në maj 2009 në rindërtimin e kishave të dëmtuara gjatë trazirave të vitit 2004. KOS-i zgjodhi çështjet e brendshme politike dhe u pajtua të vazhdonte të merrte pjesë në KZR. Të gjitha palët e KZR-së, përfshirë këtu Qeverinë, u pajtuan për një procedurë të re të tenderimit.

Priftërinjtë, murgjit, dhe laikët e KOS-it i zunë disa objekte të rindërtuara të KZR-së gjatë periudhës raportuese.

#### Seksioni III. Statusi i respektit shoqëror për lirinë e fesë

Dhuna shoqërore shënoi rënie, por tensionet ndërmjet bashkësive mbetën të larta. Diskriminimi dhe dhuna shoqërore dukeshin të ishin në përgjithësi me motive etnike, por lidhja e ngushtë ndërmjet përkatësisë etnike dhe fesë e bëri më të vështirë të përcaktohej nëse ngjarjet ishin të motivuara nga armiqësia etnike apo fetare. Ndonëse shumica e shqiptarëve të Kosovës e identifikojnë veten si myslimanë, ky përcaktim ka më tepër domethënie kulturore se fetare. Serbët e Kosovës e identifikojnë veten me KOS-in, e cila e definojnë jo vetëm fenë e tyre, por edhe perspektivën e tyre kulturore e historike.

Pati raportime për sulme të drejtuara kundër bashkësisë dhe pronës ortodokse serbe, përfshirë këtu kërcënimet, vjedhjet dhe vandalizmin. Pati raportime për incidente të hedhjes së gurëve dhe për sulme të tjera kundër klerikëve ortodoksë serbë gjersa udhëtonin jashtë manastireve të tyre. Përveç kësaj, pelegrinët serbë që udhëtonin me autobus nga Serbia për të marrë pjesë në shërbime në manastirin e Deçanit shpesh gjuheshin me gurë, zakonisht nga fëmijët. Në komunat perëndimore të Pejës, Deçanit, Gjakovës, Istogut, Klinës dhe Skenderajt, dhe gjithashtu në Mitrovicën jugore (zonat që përshijnë Patriarkanën e Pejës, manastirin e Deçanit, Goriocit, Budisalcit dhe të Deviqit), klerikët kërkuan përcjellje nga forca paqeruajtëse ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO (KFOR) dhe ajo ua siguroi atë. Klerikët

theksuan se nuk mund t'i vizitonin anëtarët e kishës në perëndim (ku edhe gjenden vendet më të rëndësishme të shenjta të KOS-it) pa përcjellje, dhe anëtarët i cituan kërcënimet për sigurinë e tyre si pengesa për mundësinë e tyre për t'i vizituar vendet e shenjta. Murgjit e murgeshat në disa manastire gjoja nuk i shfrytëzonin pjesët e pronave të manastireve, shpesh tokën jashtë mureve të manastirit, për shkak të brengave të sigurisë.

Në qershor 2009, kryetari dhe zyrtarë të tjerë të Klinës dënuan përdhosjen e një varreze në fshatin serb Videjë, ku vandalët dëmtuan dhjetë gurë varresh. Disa OJQ, përfshirë këtu Këshillin e Kosovës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, gjithashtu e dënuan përdhosjen. Qeveria komunale pagoi për riparimin dhe restaurimin e varrezave.

Ndonëse më parë protestantët raportnin për përmirësim të vogël në gjendjen e tyre të përgjithshme, ata raportuan për dhunë dhe diskriminim të shtuar gjatë periudhës raportuese. Një listë e emrave të ministrave dhe misionarëve protestantë, përfshirë këtu shqiptarë të Kosovës dhe misionarë të huaj, bashkë me mbiemrat, adresat, numrat e telefonit, dhe emrat e kishave apo organizatave të tyre përkatëse, mbeti në dispozicion në rreth 100 ueb sajte private. Ky informacion ishte dhënë fillimisht në nëntor 2007 në ueb sajtin e degës së Bashkësisë Islame të Kosovës në Gjakovë.

Protestantët individualë pohonin diskriminim verbal. Ndonëse disa kisha protestante ishin thyer e plaçkitur gjatë periudhës raportuese, udhëheqësit e bashkësisë nuk i konsiderojnë këto incidente të motivuara nga diskriminimi fetar.

Incidentet ishin gjoja të drejtuara kundër bashkësisë myslimane, përfshirë këtu vjedhjet, vandalizmin dhe kërcënimet.

Shqiptarët katolikë, ortodoksë dhe myslimanë raportuan se nuk kishin probleme me shqiptarët etnikë që u përkasin grupeve të tjera fetare. Megjithatë, ka pasur disa probleme ndërmjet grupeve shqiptare myslimane.

Më 9 janar 2009, një grup prej nëntë shqiptarëve etnikë, që i përkisnin një sektit vahabist, rrahën rënd klerikun mysliman Mulla Osman Musliun gjersa ishte duke hyrë në një xhami në fshatin Zabel të Ulët të Glllogocit. Policia ndaloi nëntë të dyshuar dhe arrestoi pesë prej tyre. Më 16 janar 2009, Musliu i tha një gazete lokale se ai nuk do t'i lejonte vahabistët t'i merrnin përsipër xhamitë e tjera lokale në Glllogoc. Musliu gjithashtu kritikoi kreun e BIK-ut Naim Tërnavë që nuk u ngrit kundër vahabizmit. Ai u tha mediave se pati disa imamë vahabistë që predikonin pa miratim paraprak nga BIK-u. Gjithashtu, më 16 janar 2009, një gazetë tjetër lokale botoi një artikull duke vënë në pah se xhamia ku ndodhi sulmi kishte qenë e mbyllur. Zyra e Bashkësisë Islame në Glllogoc gjoja kishte kërkuar që qeveria komunale të ndërmerre masa për ta penguar mbajtjen e aktiviteteve fetare islame pa miratimin e BIK-ut, duke cituar brengat e sigurisë.

Në fillim të 2009-ës, Policia e Kosovës (PK) miratoi procedura të reja operative për të siguruar mbrojtje më të madhe për objektet fetare e kulturore serbe. PK u pajtua të ofronte mbrojtje më të madhe për objektet më të rrezikuara ortodokse serbe, siç ishte përcaktuar nga zyrtarët e KOS-it. Zyrtarët e PK-së deklaruan se kishin vendosur roje 24-orëshe në Kishën e Shën Nikollës në Prishtinë. Ata gjithashtu raportuan se ishin duke patrulluar afër objekteve të tjera kulturore serbe. KFOR-i raportoi se ishte duke ruajtur manastirin e Pejës, Deçanit, Budisalcit, Goriocit, Deviqit, dhe të Arkangjelit.

Më 18 shtator 2008, Jeton Mulaj u dënua për shtënie me mortajë dore në manastirin e Deçanit në vitin 2007 dhe u dënua me tri vjet e gjashtë muaj burg.

Udhëheqësit katolikë raportuan se kishin marrëdhënie të mira me bashkësinë myslimane, por kishin pak kontakte bilaterale me udhëheqjen e KOS-it. Udhëheqësit katolikë dhe të KOS-it e konsideronin njëri-tjetrin shumë të politizuar. Bashkësia myslimane gjithashtu raportoi për marrëdhënie të mira me udhëheqjen katolike, por për bashkëveprim të kufizuar me bashkësinë ortodokse.

Udhëheqësit myslimanë, katolikë dhe disa udhëheqës ortodoksë vendës u përpoqën ta inkurajonin tolerancën dhe paqen në sferën fetare dhe politike. Megjithatë, zbatimi i planifikuar i konkluzioneve të konferencës ndërfaqetare të vitit 2006, organizuar nga Norewegian Church Aid [Ndihma e kishës norvegjeze], vazhdoi të ngecte në fazën planifikuese për shkak të ngurrimit të udhëheqjes së KOS-it për të marrë pjesë në të.

#### Seksioni IV. Politika e Qeverisë Amerikane

Si pjesë e politikës së vet për mbështetjen e tolerancës etnike dhe fetare, Qeveria Amerikane i diskuton çështjet e lirisë së fesë me Qeverinë dhe përfaqësues fetarë. Shumë zyrtarë të lartë dhe ushtarakë të lartë të Qeverisë Amerikane vazhduan të takoheshin me udhëheqës politikë e fetarë për ta vlerësuar situatën dhe për ta nxitur pajtimin dhe përparimin drejt një shoqërie më tolerante shumetnike.

Zyrtarët amerikanë gjithashtu mbajtën kontakte të ngushta dhe rregullisht u takuan me udhëheqësit fetarë të serbëve ortodoksë, myslimanëve, katolikëve dhe protestantëve për t'i diskutuar brengat e tyre dhe për ta mbështetur dialogun ndërfaqetare. Zyrtarët amerikanë nxitën dialogun ndërmjet anëtarëve të KOS-it dhe anëtarëve shqiptarë të Qeverisë. Qeveria Amerikane vazhdoi ta mbështeste Qeverinë dhe Këshillin e Evropës në rindërtimin e objekteve fetare të dëmtuara gjatë trazirave ndërtnike më 2004 dhe të ndërhynte me zyrtarë të qeverisë në emër të interesave të KOS-it kur të drejtat e KOS-it kërcënoheshin apo shkeleshin. Trupat paqeruajtëse të KFOR-it amerikan punuan për ta parandaluar dhunën etnike e fetare, dhe i ruajtën objektet fetare.

Qeveria Amerikane vazhdoi t'i financonte 80 policë amerikanë të caktuar në misionin e BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë dhe siguroi përkrahje të konsiderueshme për PK-në, të dy palët punonin për ta parandaluar dhunën etnike e fetare. Diplomtatë amerikanë punonin me personelin ushtarak amerikan të caktuar në KFOR për t'i mbrojtur objektet fetare në zonën e përgjegjësisë së ushtrisë amerikane dhe mbështetën përpjekjet për rindërtimin e kishave të dëmtuara apo të vandalizuara. Përfaqësuesit e Qeverisë Amerikane ndërhyjnë për ta mbrojtur integritetin e zonës së posaçme mbrojtëse të Deçanit. Puna restauruese vazhdoi në shtatë projekte rindërtimi të financuara përmes një granti një milion dollarësh të Qeverisë Amerikane si pjesë e përpjekjeve të UNESCO-s për ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të Kosovës.